



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTTAREVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA

Nr. 01 Br. 9236

Nr. i faq. 1 Data: 22/03
Br. str. Datum: 2024
KAMENICË/A

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Kuvendi Komunal i Kamenicës

Datë: 22.03.2024

Mbështetur në nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 3 paragrafi 1 pika 1.2, nenin 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës,

Kryesuesi i Kuvendit me datë: 22.03.2024 :

T H Ë R R E T

Mbledhjen e III-të (të rregullt) të Kuvendit Komunal e cila do të mbahet ditën e **Premte** me datë: **29.03.2024**, duke filluar nga ora **13:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës.

Për mbledhje propozoj këtë,

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit, nga mbledhja e 2-të e Kuvendit Komunal për vitin 2024.
2. Pyetje legjislativiteti drejtuar ekzekutiviteti.
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft-Statutit të QKMF-së.
4. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar për vitin 2023.
5. Të ndryshme.



Liridon KASTRATI

Kryesues i Kuvendit të Kamenicës



Republika e Kosovës

Republika e Kosovës

Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës

Opština Kamenica

Kamenica Municipality



PROCESVERBAL

Nga mbledhja e II-të e Kuvendit të Komunës

Mbledhja u mbajt në objektin e komunës e mbajtur më: 29.02.2024 dhe filloj ora 10:15. Në mbledhje përveç delegatëve të kuvendit, të pranishëm ishin edhe Kryetari i Komunës, disa drejtor të drejtorive komunale, përfaqësues nga zyra për Integrime Evropiane, përfaqësues të Policisë së Kosovës, Shërbimi profesional i kuvendit, zyra ligjore, përkthyesi, zyra e informimit, përfaqësues të OSBE-së, OJQ dhe media lokale. Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, Liridon Kastrati i cili për mbledhje propozoi këtë:

Rend dite

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e I-rë e Kuvendit Komunal,
2. Pyetje e legjislativit drejtuar ekzekutivit,
3. Propozim-vendim për miratim të propozim-vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë për "HYdajet Pireva B. I" me procedur të negocimit të ofertës,
4. Propozim-Vendim për Themelimin e Komitetit për Zhvillim Ekonomik Lokal,
5. Propozim-Vendim për dhënie të shfrytëzim afatshkurtë të pronës së paluajtshme komunale përmes ankandit publik -Lokal Objekti Shtëpia e Kulturës " Isa Kastrati"
6. Propozim-Vendim për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës përmes ankandit publik Lokaj Objekti Shtëpia e Kulturës " Isa Kastrati",
7. Propozim-Vendim për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për Policin e Republikës së Kosovës SPMK-MUÇivërcë,
8. Propozim-Vendim për ndryshimin dhe plotëzimin e Vendimit Bazë Sh.01 Nr. 7976,
9. Të ndryshme

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës, para se me filluar konstatojmë se kemi kourum të mjaftueshëm për të filluar seancën, nëse keni propozime shtesë fjala është për ju.

Magbule Kastrati-ndihmë financiare për Abaz Morina, i cili është me shëndet jo mirë dhe ka nevojë për financim dhe kërkoj që ta mbështesim të gjithë asambleistët në vlerë prej 3 mijë euro.

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës, e gjithë mirëkuptimin dhe besueshmërinë që ky ka nevojë për ndihmë financiare në grup me shefat e grupeve kemi vendosur që shefat e ndihmave momentale për mbështetje financiare për shkak të vonesave që po na bëhen nga ministria edhe vitin e kaluar ka ndodhur që 3 ose 4 raste që nuk iu janë lëshuar të hollat që janë votuar nga kuvendi për shkak të vonesave nga ministria, zyra e thesarit këto i kemi adresuar tek

komisioni për ndihma momentale dhe komisioni ka të drejt me nda vlerën deri në 2 mijë euro. A keni propozime të tjera nëse ju nuk keni unë kam katër propozime:3 propozime kanë të bëjnë me dëmet që janë shkaktuar nga fatkeqësit për vitin 2023. P

- A) Po fillojmë me draft planin e punës së KKS-së, siç dihet KKS-jë për vazhdimin e aktiviteteve të tyre fillimisht e miraton draft planin e punës e që kërkoj nga ju që të njëjtin ta aprovojë për këtë rend dite

Kush është që kjo pikë të hyjë në rend dite?

Për.....të gjithë

- B) Propozim-vendim për miratimin e raportit përfundimtar të hartuar nga komisioni profesional i komunës për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore, gjegjësisht nga breshëri në pëmishten e Ardina Veliut

- C) Në pëmishten e Valbona Pirevës

- D) Në pëmishten e Naim Huruglicës

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës-janë tri propozim-vendime por për shkak të natyrës e kanë të njëjtën lidhshmëri dhe përmbajtje, mendoj se këto tri propozime i shtimë në një pikë të përbashkët. Komisioni komunal i ka vlerësuar dëmet në punishtet e tyre nga breshëri ndërsa kompenzimin e tyre e bënë ministria e bujqësisë.

Kush është që kjo pikë të hyjë në rend dite?

Për.....të gjithë

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës-vazhdojmë me miratimin e tërësishëm të rendit të ditës?

Kush është për miratimin e rendit të ditës?

Për u deklaruan të gjithë.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e I-rë e Kuvendit Komunal

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës-a kemi vërejtje rreth procesverbalit ?

Nëse nuk kemi e hedhim në votim, kush është për miratimin e procesverbalit?

Kundër, abstenim nuk kemi Konstatohet se miratohet ky procesverbal.

2. Pyetje të legjislativit drejtuar ekzekutivit,

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës, a ken pyetje?

Jeton Biqkaj-një pyetje e kam adresuar për drejtorin e arsimit për mbylljen e konviktit në Kamenicë, pyetja ishte: a ka nxënës të cilët e kanë shfrytëzuar konviktin dhe në përgjigjen me shkrim është thënë se ka, por e kemi subvencionuar udhëtimin për shkak të kushteve të vështira në konvikt. Mendoj se mbylljes së konviktit është dashur të i paraprijë një vendim i kuvendit dhe jo të mbyllet në këtë form që mendoj se e ka një simbolik që Kamenica e ka pasur një konvikt. Tjetra është që ka të bëjë me qent endacak, mendoj që është shqetësim i jashtëzakonshëm, ngase kalimtarët kanë frikë në mëngjes apo në mbrëmjet të lëvizin nga qent endacak paraqesin një rrezikshmëri të madhe. Para disa ditëve kam ndërgjuar që e kanë sulmuar një fëmijë në lagjen "Malësia" e di se është edhe ligji për mbrojtjen e kafshëve por duhet të bëhet një zgjidhje urgjente që të eliminohet ky rrezik deri sa nuk ka ndodh ndonjë fatkeqësi. Pyetja tjetër është që komuna nuk ka arritën të jetë përfituese e grantit të performancës dhe cili është plani i juaj që ne të jemi përfitues të këtij granti. Kur dihet se

disa komuna që janë përfituese të këtij granti nuk kanë ndonjë kapacitet më të madh se komuna e jonë.

Magbule Kastrati-edhe më herët kam pyetur se ku është kaldaja e shkollë " Fan Noli" si dhe drunjët e kulmit të kësaj shkolle, më duket se keni thënë se janë në shkollën profesionale tek gjimnazi dhe dëshira jem është të shkojm dhe të vërtetojm se a është aty ajo kalda pasi që kjo ka një kosto të lartë në vlerë 4-5 mijë euro. A mund të shkojm bashkarisht ne si asambleist së bashku me ju kryetar dhe mediat e ta vërtetojmë se a është aty.

Sejdi Kurteshi-në shkollën e Busavatës në klasën e katërt edhe pse mësuesja është në pushim të lehonisë në gjysmëvjetorin e parë dhe të dytë kjo klasë nuk mbanë mësim ose mbajn pjesërisht mësim me një formë cili mësues të jetë i lirë ju jep mësim.

Egzona Isufi-a është e vërtet që është epunësuar si mjeke në QKMF në Kamenicë, bashkëshortja e avokatit tuaj që ju shërben.

Jadranka Nikolic-dua të ndërldhiem për kaldajën e shkollës, pyes për kaldajën që ka qenë me nxemje të lëngët, po ashtu kam pyetje për sektorin e arsimit kam një lutje nga Divna Arsic, gruaja që ka punuar në kopsht të fëmijëve në Strezoc nga viti 2002 ju keni informata dhe nuk dëshironi që të diskutoni lidhje me këtë. Ajo drejtohet për shkak të zvendësimit të drejtorit sigurisht personi që pak e njeh ligjin e mos të them që fare nuk e njeh ligjin për shkak të mungesës së procedurave dhe pa kurrfarë vërejtje ashtu që Divna Arsic nga fshati Strelac do të ndërmarrin iniciativë kundër drejtorit të arsimit i cili thekson se gjëja se personi nuk është gjendur në vendin e punës dhe në të vërtet nuk e din se për cilin kopsht bëhet fjalë. E keni sjell një person që nuk gjendet në sistemin e pagave të Kosovës, a e keni takuar diku në rrugë apo është preferencë e punës. Kjo nuk është pyetje e imja por është pyetje e komunitetit serb.

Lirim Kryeziu-kur do të përfundojë renovimi i shkollës " Metush Krasniqi", pasi të gjithë nxënësit janë duke mbajtur mësim tek shkolla " Sejdi Kryeziu"? Pyetja tjetër: Renovimi i fushës futbollit ka filluar por që një kohë të gjatë janë ndërprerë punimet, korriku është afër dhe turneu më i madh në KOsovë është afër, nëse dështon turneu do të humbim shumë si komunë edhe ashtu është evneti më i madh në komunë.

Arbnore Beqiraj- kam një kërkesë pengesa e vendosur pranë shkollës " Asllan Thaçi" në Karaçevë të Poshtme është dëmtuar nga makinerit për mirëmbajtjen e rrugëve gjatë stinës së dimrit dhe ajo rrugë prap ajo rrugë paraqet rrezik për ata nxënës nëse ka mundësi me bërë intervenim për rregullimin e kësaj pengese.

Egzona Isufi-përgjigjjet na ka mbetur borxh kryetari të dy seancave të kaluara për të cilat keni thënë se do të kthehen në mënyrë elektronike.

Bleta Ajeti-kur do të bëhet kyçja në ujësjellës nga banorët e lagje " Malësia" dhe Grizime për shkak që gypat kryesor janë vendosur por kyçja individuale nëpër shtëpi nuk është bërë ende.

Kadri Rahimaj-Kryetar i Komunës së Kamenicës, pyetja nga z. Bëku: Grandi i performancë edhe vitin e kaluar kemi një raport të auditorit me opinion t ëkualifikuar për shkak se pasqyrat financiare financiare nuk paraqesin një pamje të drejt dhe arsyeja është mbivlerësimi i pasurive të luajtshme dhe atyre të paluajtshme. Është gabimi i dytë që komuna e Kamenicës e përsërit ka qenë një zyrtar në moshë i cili nuk e ka pasur njohurin adekuate se si të raportojë mbi vlerën e e pasurive në pasqyrat financiare dhe atë zyrtar e kemi transferuar në një pozitë tjetër duke e marrë një zyrtar të re që të bëjë paraqitje të drejt të pasqyrave financiare. Në raport me performancën komunale Komuna e Kamenicës ka pasën raportin më të mirë ndonjëherë, por katër kriteret minimale që është dashur me u plotësuar e që njëri prej tyre është raporti i auditorit e ka pamundësuar aplikimin e grandit të performancës dhe rrjedhimisht nuk përfitojmë nga grandit i performancës, por nuk është që mbesim keq se po marrim mjete jashtë zakonisht shumë edhe nga ministritë. Sa i përket pyetjes së znj. Magbule, ka ngritur shqetësimin e kaldasë, ne e kemi hartuar projektin e shkollës " Fan Noli", në projekt qeket që specifikisht që operatori e ka përgjegjësi për me i ruajtuar dhe demoluar objektet dhe pasuritë brenda atyre objekteve që nuk kanë më vlerë dhe operatori ekonomik është duke i vizituar që ose ti kthejë në funksion ose ti ruaj. Komuna e Kamenicës ka kërkuar që kaldanë që ka qenë brenda projektit nëse nuk futet në përdorim për mbrojtje të shkollës të rikthehet në shkollën

profesionale dhe fëmijëvet të ju shërbejë për praktikë. Projektin mund ta merrni ta lexoni që ne e kemi kryer detyrën ndërsa operatori ekonomik i ka keqpërdor ato deh do të mbajë përgjegjësin përmes drejtorit tek operatori ekonomik që me i respektuar projektin për ndërtimin e shkollës mesme. Deri më tani kemi punësuar 6 mjek dhe do të punësojmë edhe të tjerë mund të jetë që punësohet edhe i afermi edhe tezja, daja etj se është ëpofesion fisnik por asnjëherë me padrejtësi. Në qështje të mjekësis ne e kemi parimin që ata më të mirët do të ecin përpara nuk është e njejt edhe kritika në raport me konkursin e mëhershëm kur nuk është pranuar, ndërsa në konkursin e dytë kur është pranuar ekziston kritika. Nëse vërehet që konkursi është i drejt nuk hezitojmë atë konkurs e kthejmë në pikën zero nuk ka pasur asnjë ankesë prej kandidatëve dhe unë nuk kam avokat personal. Shkolla "Metush Krasniqi" që po financohet nga Bashkimi Evropian, po thuajse është në fazën finale ka mbetur që të aprovohen disa punë siç janë dyert e klasëve në mënyrë që të vazhdohet në pozicionet tjera. Unë mendoj që mbi 90% e punëve janë përfunduar dhe menaxhimin e asaj kontrate e bënë Bashkimi Evropian, ndërsa për renovimin e fushës së futbollit ne e kemi ndërprerë kontratën me operatorin e parë për shkak që nuk e ka plotësuar kontratën sipas kërkesës tonë. Kemi bërë edhe konfiskimin e sigurimit të këtij operatori, ndërsa kemi nisur më shumë se një javë procedurën e re për rifillimin e punëve dhe kjo procedurë do të jetë në ritenderim për 20 ditë. Sa i përket për ujësjellësin është kompetencë e "Hidromoravës" ku menaxhon tani me ujësjellës të bëjë kyçjen dhe zgjerimin e ujësjellësit dhe nuk është në kompetencën e komunës. Në ato zona ku menaxhon "Hidromorava" të bëjë kyçjen dhe zgjerimin e ujësjellësit. Unë kam takuar edhe qytetar dhe i kam njoftuar se kërkesa duhet të bëhet në "Hidromorav" dhe kjo e fundit ka edhe kapacitetin edhe mundësinë që të bëjë zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit në fshatin Grizime dhe lagjet tjera të qytetit, ndërsa ne kemi një marrëveshje me "Hidromoravës" me gjashtë fshatra në vlerë mbi 300 mijë euro për kyçje individuale, procedurat tashmë janë shfaqur duhet të priten ofertat, ndërsa në lagjen "Iliria" dhe një pjesë e lagjes "Jehona" do të intervenohet në sanimin e rrjetit të furnizimit me ujë të pijshëm dhe vendosjen e orëmatësve të mençur në këtë pjesë duke eliminuar edhe gypat e azbestit që kanë një bazë për përhapjen e sëmundjeve kancerogjene.

Afrim Dervishi-Drejtor i Arsimit, në drejtorin e arsimit ka angazhime të vazhdueshme por jo të gjitha po arrijmë të i realizojmë pasi që po ka edhe kushtëzime të tjera që e pamundësojnë. Konvikti nuk është ende gjendje të mirë për shkak të infrastrukturës. Nga vizitat që kemi bërë kemi konstatuar që fëmijët me jetuar aty është e pamundur dhe me ja siguruar mirëqenien e tyre. Kemi konstatuar se nuk bënë me i lënë fëmijët aty duke ja shtuar faktin që koston që paguajmë për transportin e tyre nuk mbërrin as sa gjysa e shpenzimeve sikur ata që rrin aty duke e shtuar që nuk mund të ja sigurojmë mirëqenien. Deri në një renovim ose trajtim infrastrukturor, konvikti konsiderojmë që nuk i përmbush kushtet për banim. Ligji për shërbyesit civil është aprovuar ka mesi i gushti i vitit të kaluar dhe deri në funksionalizimin e tij operativ digjital ka zgjat diku 2 muaj dhe kjo e ka bërë të pamundur shpalljen e konkursit për pozitë e reja dhe nevojat në arsim, kjo ka qenë për krejt Kosovën mirëpo nevojat tona për mësimdhënës të rinj ka qenë një sfidë që edhe ju po e shfaqni këtu. Edhe pse është shpall konkursi janë bërë vonesat në trajtimin e konkurentëve, dokumentacioneve për faktin që me ligj duhet të jenë 5 vetë në komision dhe njëri prej tyre brenda asaj periudhe e pamundur pa qenë ose i sëmur ose rast vdekje, ose shqetësime të tjera të cilat e kanë penguar komisionin me kryer punën deri në përfundim. Edhe kur u përfunduar pune njëri nga konkurentët është ankuar në komisionin për ankesa të komunës dhe për shkak që nuk kemi arritur të respektojmë afatet kohore të procedurave për përzgjedhjen e punëtorëve arsimor, komisioni ka konstatuar shkelje dhe ka anuluar pjesërisht konkursin dhe kjo ka të bëjë me mësimdhënësit klasor për të cilët z. Kurteshi po e ngrit shqetësimin. Ne jemi munduar që fëmijët mos të humbin orë por të dërgojmë mësimdhënës të kualifikuar por që mbajn edhe praktikë dhe mësimi mos me humb.

Sejdi Kurteshi-ligji e lejon për lehonit por ligji nuk e thot që nxënësit me mbetur pa mësues, nuk e dij në arsim a e lejon ligji me marrë me kontratë në vepër meqenëse fëmijët janë duke e humb mësimin kjo është shumë që një fëmijë me i humb 5 muaj.

Egzona Isufi-shqetësimet që i kemi adresuar kryetari nuk ishte në dy seanca, jeni zotuar që do të ktheni përgjigje dhe ato nuk janë kthyer.

Magbule Kastrati-ju së pari jeni një drejtor që keni përfunduar nota vet atëherë qka kërkon drejtësi.

3. Propozim-Vendim për miratim të propozim-vendimit për dhënien e pronës së paluajshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë për “Hydajet Pireva” B.I, me procedurë të negocimit të ofertës,

Burbuqe Leka – Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Diasporë, bëhet fjalë për negocimin e ofertës ngritja e plantacionit në arë nga “Hydaje Pireva B.I” objekt i negocimi ka qenë dhënia e pronës komunale në zonë kadastrale në Kamenicë. Afati i dhënies me qera të pronës është negociuar për 20 vite, qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës për subjektin në fjalë është jetësimi i projektit ngritja e plantacionit me kapacitet dhe aktivitete në projektin e propozuar. Hydajet Pireva në emër të kompenzimit për shfrytëzimin e pronës komunale do të paguajë komunës qira vjetore në vlerë prej 1% të qarkullimit vjetor të subjektit “Hydajet Pireva B.I” por jo më pak se çmimi i qeras së tokës i përcaktuar në rregulloren komunale. Vlera e investimit nga Hydajet Pireva do të jetë 141 mijë 740 euro duke u bazuar në planin dinamik që e ka dorëzuar. Për të siguruar që investimet dhe realizimet e planit investues Hydajet Pireva detyrohet të ofrojë një polis të sigurimit apo garancionit bankar në vlerë prej 30 mijë euro e cila do të shërbejë në rast të dështimit të investitorit, po ashtu raporton tek komuna e Kamenicës çdo gjashtë muaj mbi implementimin e projektit në vlerën e investimeve. Hydajeti duhet të përfundojë investimet sipas planit në afat prej një viti nga pajisja me leje për investim. Numri i minimal i punëtorëve prej 4 punëtorë deh nuk guxon të bie më poshtë në asnjë periudhë të secilit vit kalendarik pa koordinim dhe pajtim em komunën e Kamenicës, prej momentin që i fillon punët me kapacitet të plotë. Do të synohet maksimalisht që punëmarrësit të jenë të komunës së Kamenicës. Hydajeti nuk ka të drejtë të shfrytëzojë burimet natyrore jashtë nevojave të brendshme të aktivitetit biznesor, sipas ligjit për sponsorizim të sportit dhe artit biznesi do të përzgjedh një nga organizatat kulturore apo sportive të komunës për sponsorizim. Ndryshimi destinimit të shfrytëzimit të pronës komunale nuk mund të bëhet pa miratimin paraprak nga komuna e Kamenicës. Komuna miraton në tërësi projektin, veprimtarit sipas planit të biznesit të projektit të Hydajet Pirevës gjatë periudhës së paraparë në planin dinamik. Ndërsa, hydajeti ruan të drejtën për modifikimin e veprimtarive brenda projektit sipas nevojës, kërkesës dhe rregulloreve në fuqi. Kjo është oferta e cila është negociuar.

Florim Kryeziu-tek pika e 5 Hydajet Pireva në emër të kompenzimit për shfrytëzimin e pronës komunale do të i paguajë komunës qira vjetore në vlerë prej 1% të qarkullimit vjetor nga subjekti por jo më pak se çmimi i qerasë. Marrëveshjen që e keni negociuar është arra dhe arra sigurisht 5-7 vite nuk ka prodhim të vetin dhe për këto vite si do të ja merrni ju atë 1% pasi që nuk ka benefit për këto vite dhe për këto vite vetëm ka me dhënë e nuk merr asgjë

Burbuqe Leka – Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Diasporë-nëse nuk e mbërrin atë vlerë do të paguajë vetëm në bazë të rregullores komunale por në rast se do të ketë qarkullim e paguan vlerën 1% komunës.

Florim Kryeziu- si guxon një komunë me detyruar me dhënë kosto për sponsorizim aty vetëm ligji mundet me kushtëzuar.

Burbuqe Leka – Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Diasporë- këtë ofertë e kemi lexuar para palës dhe pala është pajtuar me këtë ofertë, këtu i ka pasën dy punëtorë ai vet ka kërkuar me rrit me bërë numrin e punëtorëve 4.

Kadri Rahimaj-Kryetar i Komunës së Kamenicës- ofertën e kemi negociuar dhe nuk është hera e parë që komuna jonë negocion me një standart të tillë por në fillim këto janë kushtet ndaj operatorit ose palës që ka interes me marrë në shfrytëzim këtë pasuri të komunës. Nëse enuk ka qarkullim deri në 5 vite do të paguan vlerën e qerasë në bazë të rregullores. E dyta tek sponsorizmi është ligji mbi sponsorizimin e sportit dhe për me kushtëzuar këto janë kushtet, ngase kjo është në favor që paret që i qarkullon një biznes me i lënë në Kamenicë dhe nuk është e jashtëligjshme dhe për me kanë shumë e sigurt ligjshmërinë e këtij akti e sheh edhe një organ tjetër që është MAPL-ja. Ju mund të

jepni pronën me këto kushte ose të shtoni ende kushte të tjera ose edhe ti largoni të gjitha kushtet në varësi qysh ju e shihni interesin publik.

Florim Kryeziu-unë mendoj se duhet të ju ndihmohet edhe në mundësi të suazave ligjore, kjo parcelë nuk shkon me negociim por me ofertë të hapur, por numrin e punëtorëve është keq me ja kushtëzuar.

Kadri Rahimaj-Kryetar i Komunës së Kamenicës-ne së pari duhet me ja dhënë pronën për me pas mundësi me bërë një menaxher nuk mundemi me bërë menaxher diku që ende sja kemi dhënë pronën, kushtet i ka pranuar por nëse nuk ju pëlqejnë kushtet merrni ndryshim. Pas kalimit të këtyre kushteve në asamble shqyrtohet akti në aspektin ligjor, krijohet kontrata për menaxhim dhe detyrimet e palës dhe detyrimet e komunës dhe mandje caktohet menaxheri.

Florim Kryeziu-unë jam për këtë me ju larguar 5 vitet e para mos me ja kërkuar 1%, ngas enuk ka çka të jep për këto vite, as me 4 punëtor nuk është mirë me obliguar.

Kadri Rahimaj-Kryetar i Komunës së Kamenicës-ne nuk e kemi kushtëzuar ndoshta ai ka nevojë për katër punëtor dhe duhet em i deklaruar, ne i kemi thënë minimalisht 2 punëtor ai ka thënë që unë do ti marr 4 punëtor dhe për deri sa ai i ka nënshkruar me vullnet dhe vetëdije të plotë ai e ka shqyrtuar të gjithë planin e biznesit se si do ta realizoj.

Magbule Kastrati-ne si grup e përkrahim këtë iniciativë për z. Pireva, mendimi jem është që atë 1% me larguar pasi që arrat nuk prodhojnë në katër ose pes vitet e para, nëse nuk do mbjell arra unë kërkoj që pas pesë vitesh të i merret kjo hapësirë publike.

Sejdi Kurteshi-qiraja duhet të jetë në bazë të rregullores në fuqi është mirë me precizuar në bazë të metres katror ose ha/tokë i kushton qiraja. A dop të filloj nga starti me paguar qirajën apo jo, e dyta jo brenda mundësive me pa pasën 4 punëtor, kontrata është mirë me precizuar dhe mos me kushtëzuar për numrin e punëtorëve.

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës,pasi keni dakordancë që ky propozim të vazhdojë tutje, po vazhdojmë me procedurë të votimit,

Kush është për miratimin e kësaj pike?

Për.....18

Kundër0

Absntenim.....0

4. Propozim-vendim për Themelimin e Komitetit për Zhvillim Ekonomik Lokal

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës, kemi pikën e katër të rendit të ditës edhe për këtë pikë fjalën ja kalojmë drejtoreshës Burbuqe Leka.

Burbuqe Leka – Drejtorja për Ekonomi, Zhvillim dhe Diasporë-kemi paraqitur një propozim të rëndësishëm për forcimin e zhvillimit ekonomik lokal në komunitetin tonë për këtë kam sygjerruar formimin e një nënkomiteti për zhvillim ekonomik lokal i cili do të përqëndrohet në rritjen e mundësive për bizneset tona të zhvillohen dhe të përparojnë. Për të kryer këtë detyrë me sukses ka qenë dhe është e rëndësishme për me identifikuar një grup të përkushtuar të pronarëve të bizneseve që janë të gatshëm të angazhohen në këtë proces dhe të kenë vullnet në përparimin ekonomik të vendit. Kemi pasur kontakte me disa biznese disa nuk kanë pranuar të jenë pjesë e këtij nënkomiteti shkaku i kohës dhe angazhimeve, kurs epronarët e bizneseve që kanë pranuar të jenë pjesë e këtij nënkomiteti do t'i propozojë 4 emra. Po ashtu jemi përkujdesur edhe për barazi gjinore emrat që do t'i propozojë janë : Kadrije Mustafa pronare e biznesit " Bio Alta", aktiviteti i biznesit është përpunimi dhe konzervimi i frutave, perimeve dhe prodhimi i uthullave, Fatmir Krasniqi pronar i biznesit " Fungo ", Batri Januzi pronar i bizneseve, kompani e ndërtimeve banesore dhe Ibadete Sadiku pronare e biznesit " Gollaku Food", aktiviteti i biznesit përpunimi dhe konservimi frutave dhe perimeve. Këta jën të propozuarit për të përfaqësuar interesat e bizneseve në komunën tonë mendoj se do të sjellin një kontribut të qmuar dhe perspektivë të pastër në diskutime dhe strategjitë që kanë me u diskutuar. Po ashtu edhe në KPF kam thënë se mund të jepni edhe ju propozime dikend që ju e vlerësoni.

Magbule Kastrati-sa anëtarë duhet të caktohen nga asambleja?

Burbuqe Leka – Drejtorja për Ekonomi, Zhvillim dhe Diasporë-e kemi diskutuar me kryesuesin dhe ka mbetur që ky komision të jetë me 9 anëtar.

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës-në këtë komision do të jenë katër anëtarë nga bizneset, katër anëtarë nga kuvendi dhe një nga shoqëria civile.

PDK propozon Rinë Krasniqi

PSD propozon Albana Ajvazi

LVV propozon VAleentina Kastrati

AAK propozon Labinot Skoverqani

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës nga OJQ propozojmë Lavdim Klaiqin, nëse nuk ka diskutime të tjera e hedhim në votim.

Kush është për miratimin e kësaj pike?

Për.....17

Kundër0

Absntenim.....0

5. Propozim-Vendim për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale përmes ankandit publik-Lokal Objekti Shtëpia e Kulturës “ Isa Kastrati”

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës-kjo qështje ka të bëjë me shfuqizimin e vendimin nga seanca e kaluar sa i përket “ Bonevet” , konfirmimin e ligjshmërisë e kemi filluar me procedurën për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim përmes ankandit publik, ankandi është i hapur, nëse ka diskutime për këtë pikë?

Nëse nuk ka diskutime vazhdojmë me procedurë të votimit, kush është për miratimin e kësaj pike?

Për.....17

Kundër0

Absntenim.....0

6. Propozim-vendim për formimin e komisionit vlerësues për dhënjen në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës përmes ankandit publik-Lokal Objekti Shtëpia e Kulturës “ Isa Kastrati”

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës- kjo pronë pasi që procedurat zhvillohen përmes ankandit duhet që në vete ta kenë një komision i cili do t’i vazhdojë procedurat për dhënien e pronës përmes ankandit nga ekzekutivi janë propozuar tre anëtar:Visar Dërmaku, Fadil Hoti dhe nga shoqëria civile Sherafedin Vranja. Ne si kuvend duhet t’i propozojmë dy anëtarë :

LVV propozon Selim Maliqi

PSD propozon Magbule Kastrati

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës- numri i kërkuar për këtë komision u përmbush, vazhdojmë me procedurë të votimit,
Kush është për miratimin e kësaj pike?

Për.....16

Kundër0

Absntenim.....0

7. Propozim-Vendim për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për Policin e Republikës së Kosovës SPMK Muçivërcë

Nazif Hajrizi- Komandat i Stacionit Policor për Mbikqyrje të Kufirit, duke e parë gjendjen e rëndë të objektit ku aktualisht veprojmë si SPMK dhe pamundësinë e Policisë së Kosovës dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme për me bërë një zgjidhje të shpejt e adekuate, ne me një kërkesë të drejtuar më datë:29.01, ju kemi drejtuar kryetarit që me na dhënë në shfrytëzim objektin e ambulancës në fshatin Kopërnice i cili në bazë të vizitës që kemi bërë dhe bisedave me kryetarin aktualisht ai objekt nuk shfrytëzohet. Për këtë kërkesë na ka shtyrë nevoja se gjendja në objektin aktual ku veprojmë është shumë e rëndë. Këtë e ka konstatuar edhe inspektoriati sanitar më datë:12.01.2023 e ka vizituar dhe konstatuar se qëndrimi dhe veprimi për këtë objekt paraqet rrezik për shëndetin dhe sigurin e zyrtarëve që veprojnë aty, por edhe për palët që për qfar do arsye janë prezent në këtë objekt. Ne e kemi vizituar objektin Kopërnice edhe ai nuk i plotëson tërësisht nevojat tona, por si nevojë emergjente e kemi bërë propozimin dhe kërkoj nga ju që si këshilltar ta votoni këtë propozim në mënyrë që të bëhet një zgjidhje e ëprkohshme deri në një zgjidhje afatgjate që sigurisht do ta bëjë ministria e punëve të brendshme edhe policia e Kosovës kur të krijohen mundësit buxhetore. **Magbule Kastrati-a** do të jetë prezent në këtë pikë kryetari, pasi që komandati paska biseduar me kryetarin dhe më interen të dijë se çka ka shpreh interesim kryetari.

Nazif Hajrizi- Komandat i Stacionit Policor për Mbikqyrje të Kufirit-unë e prezentova vetëm kërkesën e fundin pasi që kërkesat tona kanë qenë permanente, ngase gjendja në atë objekt ka qenë e keqe që nga emërimi jem si komandant, por deri në këtë kohë nuk është bërë zgjidhja. I kemi pasur disa takime me kryetarin i kemi shqyrtuar mundësit për një objekt, por përkundër iniciativës nuk na u është ofruar ndonjë objekt tjetër si zgjidhje adekuate. Ne kemi adresuar për këtë objekt edhe me shkrim ka hyrë në procedurë dhe tani është në autoritetin tuaj për me votuar. Në këtë objekt edhe shëndeti jonë do të dëmtohet dhe ne nuk do të mund të ofrojmë siguri të mjaftueshme për komunitetin.

Magbule Kastrati- a keni bërë kërkesë më parë për ndërtimin e objektit të ri për stacionin në Muçivërcë?

Nazif Hajrizi- Komandat i Stacionit Policor për Mbikqyrje të Kufirit-kërkesat janë adresuar edhe nga paraardhësi im dhe ky kuvend pos parcelës ekzistuese ka ndarë edhe një parcelë tjetër afër për me ndërtuar një objekt të ri unë nuk i kam parë dokumentet por ato që janë deklaruar eprorët se edhe buxheti ka qenë i ndarë për me u ndërtuar ky stacion, por për nevoja tjera ata që e planifikojnë buxhetin sigurisht e kanë parë më të nevojshme me ndarë atë buxhet dhe ne kemi mbetur në atë objekt. Nevoja për me u larguar nga ky objekt është emergjente dhe kjo është arsyeja pse ne ju kemi drejtuar komunës për me na bërë një zgjidhje të përkohshme.

Magbule Kastrati-është mirë që kryeministri të vij në komunën tonë dhe të vizitojë këtë stacion të policisë dhe të shohin se ku punojnë policët taë që neve na mbrojnë.

Arbnore Beqiraj- unë mendoj se ky stacion ka qenë në këtë gjendje edhe në mandatin e kaluar dhe është dashur me bërë një zgjidhje edhe për këtë stacion. Unë mendoj se i ndishëm është shëndeti që u rrezikohet punëtorëve që punojnë aty dhe ndërrimi i lokacionit është e përkohshme dhe nuk është e përhershme dhe deri të bëhet një zgjidhje është mirë mos me i vonuar më tepër.

Albana Ajvazi- a keni biseduar me kryesinë e fshatit Muçivërcë dhe a e keni konsideruar si objekt me shfrytëzuar ambulancën në Muçivërcë pasi ajo nuk punon dhe nuk është funksionale nga pandemia.

Nazif Hajrizi- Komandat i Stacionit Policor për Mbikqyrje të Kufirit- ne jemi duke hulumtuar për një objekt nga mandati i qeverisjes kaluar dhe një prej mundësive që na u është dhënë është edhe ambulanca në fshatin Hodonovc, por kur e kemi parë aty gjendjen se ai objekt është shumë i vogël dhe rruga që të qon aty është shumë e ngushtë dhe ne me u vendos në atë objekt do ta bllokoni komunitetin, lëvizjen e lirë të tyre dhe e kemi refuzuar si mundësi. Ne e kemi vizituar edhe

ambulancën në Muçivërcë që është e ngjitur por gjendje vetm 10 % mund të ndryshojë nga objekti jonë.

Labinot Skoverqani-policët që na ruajn neve nëse nuk e kanë shëndetin unë nuk e di se si do të mund ta kryejnë detyrën. Paskan diskutuar të gjitha mundësit, do të ishte mirë që t'i bëhet një zgjidhje më e shpejt e mundshme. Është mirë që edhe kryetari Rahimaj është mirë me i hec procedurat me pas takime dhe me ndërtuar stacionin e ri në këtë fshat e që do të zgjidhej ky problem.

Florim Kryeziu-unë në vitin 2019 e kam ngritur dorën për miratim të lokacionit që e ka kërkuar Ministria e Brendshme. Është shumë e rëndë që në shek. 21 policia mos të kenë kushte për funksionimin e detyrës. E dini se jeni afër QMF-së që është dashur me intervenuar në Roganë, jeni afër shkollës mesme dhe afër zonës së kontrabandës, kurse në Kopërnice me shkuar atje më mirë do të ishte me ardhën në Kamenicë. Në gjendjen e asaj pjese unë nuk jam për me u larguar nga ajo pjesë.

Jeton Biqkaj-realisht lëvizja prej Muçivërcit në Kopërnice është e largët dhe nuk e di se cila do të jetë siguria. Ne e dim që qështjet e sigurisë i mbulon Policia dhe ata e bëjnë vlerësimin ku dhe cili do të jetë pozicioni. Mendoj se ka objekte më afër që do të mund të bëhej zgjidhja. Kam parë që është thënë se ambulanca në muçivërcë i plotëson kushte ndoshta më mirë se ajo në Kopërnice, nëse ka të bëjë me qështje të sigurisë lëvizja e strategjisë shtetërore është diqka tjetër, por për shkak të objektit mendoj se është zgjidhje jo e duhur. Nëse ai objekt nuk i plotëson kushtet për me punuar zgjidhja duhet të bëhet, por edhe shkuarja në Kopërnice mendoj që nuk është zgjidhje është mirë të shtyhet dhe të bëhet zgjidhja më e mirë qoft me shefat e grupeve, me kryetarin e komunës dhe nëse ka të bëjë me qështje të sigurisë duhet t'i thuhet kryetarit dhe shefave të grupeve. Zgjidhja duhet me ju bërë por jo në këtë form, objektet që i ka policia mudn të lëvizion por këtu në pyetje është objektet që i ka në menaxhim komuna.

Arbnore Beqiraj-ka qenë dy ose tre herë që e kam paraqitur këtë problem të kësaj njësie dhe as nuk ka apsur sygjerrime dhe tani ka ardhën në përfundim që objekti në Kopërnice është i nevojshëm dhe i përmbush kërkesat e tyre. Është një zgjidhje permanente dhe është e përkoshme nuk është e përhershme.

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës- ambulanca në fshatit Muçivërcë është shumë e re dhe e mirëmbajtur dhe e njëjta i ka tri dhoma dhe një korridor dhe dy banjo a e keni vizituar këtë ambulancë ?

Nazif Hajrizi- Komandat i Stacionit Policor për Mbikqyrje të Kufirit-nuk ka as pesë javë që e kam vizituar objektin brenda dhe jashtë dhe realisht as nuk është e re dhe nuk i plotëson asnjë kusht për me vepruar aty. U ngritën disa shqetësime ndoshta për qështjen e dislokimit por nuk është objektivë strategjike ajo e policisë Kosovës, por është esencialisht nevojë emergjente për një zgjidhje të përkohshme për mos me qëndruar ne në atë objekt. Ndoshta ehde dikush e ka ngritur qështjen e sigurisë për mos prezencën tonë, por realisht nënstacioni në Muçivërcë që vepron në kuadër të stacionit të Kamenicës ka me mbet prezent aty me mundësinë e dislokimit në një objekt diku tjetër. Sa i përket qështjes së sigurisë së kufirit, dislokimi jonë nga Muçivërci në Kopërnice nuk e ka asnjë impakt në qështje të sigurisë kufirit për qka e kemi ne në mandat për siguri.

Florim Kryeziu-propozim vendimi është i hartuar keq titulli dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për Policinë e Republikës së Kosovës SPMK Muçivërcë, është gabim se po jepet për dhënie në shfrytëzim , këtë duhet ta përmirësoni për ndryshe kjo do të kthehet.

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës-nëse nuk ka diskutime të tjera e hedhim në votim,

Kush është për miratimin e kësaj pike?

Për.....9
Kundër10
Absntenim.....1

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës, konsiderojmë se nuk kalon ky propozim.

8. Propozim-Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit Bazë Sh.01 Nr. 7976

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës-propozim-vendimi ka të bëjë me dëgjimet buxhetore që janë ndryshuar 3 emra, a e dëshiron dikush fjalën nëse jo vazhdojmë me procedur të votimit,

Kush është për miratimin e kësaj pike?

Për.....15

Kundër0

Absntenim.....0

9. Draft-Plani i Punës së KKS-së

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës-ky draft plan i ka parapa aktivitetet e tyre, a e dëshiron fjalën dikush për draft-planin, nëse nuk keni e hedhim në votim.

Kush është për miratimin e kësaj pike?

Për.....15

Kundër0

Absntenim.....0

10. Propozim-vendim për miratimin e raportit përfundimtar të hartuar nga komisioni profesional i komunës për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore, gjegjësisht nga breshëri në pemishten e Ardian Veliut, Në pemishten e Valbona Pirevës dhe Në pemishten e Naim Huruglicës

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal- a jeni që të miratohen këto propozime dhe ministria e bujqësisë të vazhdojë për përkrahje

Kush është për miratimin e kësaj pike?

Për.....15

Kundër0

Absntenim.....0

11. Të ndryshme

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal, a keni diskutime të tjera, nëse jo e shpalli të mbyllur takimin e sotëm.

Takimi mbyllet në orën 12:30

Procesmbajtës

Sabile Arifi





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E KAMENICËS
OPŠTINE KAMENICA / MUNICIPALITY OF KAMENICA



STATUTI

I

QENDRËS KRYESORE TË MJEKËSISË FAMILJARE "Dr. SHABAN GECI" NË KAMENICË

STATUTE

of the

MAIN FAMILY MEDICINE CENTER "Dr. SHABAN GECI" IN KAMENICA

STATUT

GLAVNOG CENTRA PORODIČNE MEDICINE "Dr. SHABAN GECI" U KAMENICI

Kompetencat e Kuvendit Komunal, Në mbështetje të nenit 45, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Shëndetësi Nr. 04/L-125, Miraton: STATUTIN E QENDRËS KRYESORE TË MJEKËSISË FAMILJARE Neni 1 I - Dispozitat e përgjithshme Me këtë Statut rregullohen: dispozitat e përgjithshme, emërtimi dhe selia, veprimtaria e QKMF-së, statusi juridik, përfaqësimi dhe prezantimi, struktura e institucionit, udhëheqja dhe trupat e institucionit, zhvillimi i vazhdueshëm institucional, mbikëqyrja e QKMF-së, aktet e përgjithshme të QKMF, pronësia dhe financimi, transparenca në punë, konfidenca profesionale dhe afariste, organizimi sindikal, mbikëqyrja e brendshme dhe dispozitat kalimtare dhe përfundimtare lidhur me ushtrimin e veprimtarisë së kujdesit shëndetësor në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (në tekstin e mëtejme: QKMF).	Competencies of the Municipal Assembly, Pursuant to Article 45, paragraph 1 and 2 of Law No. 04/L-125 on Health, Adopts the following: STATUTE OF THE MAIN FAMILY MEDICINE CENTER Article 1 I – General provisions This Statute regulates: general provisions, designation and headquarter, activity of MFMC, legal status, representation and presentation, structure of the institution, leadership and bodies of the institution, continuous institutional development, supervision of MFMC, general acts of MFMC, ownership and financing, transparency at work, professional and business confidence, trade union organization, internal supervision and transitional and final provisions relating to the exercise of healthcare activity in the Main Family Medicine Center (hereinafter: MFMC).	Nadležnosti Skupštine Opštine, Na osnovu člana 45, stavke 1. i 2. Zakona o zdravlju br. 04/L-125, Usvaja: STATUT GLAVNOG CENTRA PORODIČNE MEDICINE Član 1 I - Opšte odredbe Ovim Statutom se uređuju: opšte odredbe, naziv i sedište, delovanje GCPM-a, pravni status, zastupanje i prikazivanje, struktura institucije, rukovodstvo i tela institucije, kontinuirani institucionalni razvoj, nadzor GCPM-a, opšti akti GCPM-a, vlasništvo i finansiranje, transparentnost u radu, profesionalna i poslovna poverljivost, sindikalno organizovanje, unutrašnji nadzor i prelazne i konačne odredbe u vezi sa sprovođenjem delatnosti primarne nege u Glavnom centru porodične medicine (u daljnjem tekstu: GCPM).
---	--	--

Neni 2 Statusi i QKMF 1.QKMF-ja ka statusin e personit juridik publik, me cilësi të autoritetit punëdhënës, ku organizohet, ofrohet dhe zbatohet Kujdesi Parësor Shëndetësor Publik (në tekstin e mëtejshëm: KPSH). 2.Themelues i QKMF-së është Kuvendi Komunal i Komunës së Kamenicës. 3.QKMF-ja në Komunën e Kamenicës ka filluar punën në vitin 1955, fillimisht si “Shtëpi e Shëndetit.	Article 2 MFMC Status 1.The MFMC has the status of a public legal entity, having the quality of the employing authority, where the Public Primary Healthcare is organized, provided and implemented (hereinafter: PHC). 2.The founder of the MFMC is the Municipal Assembly of Kamenica. 3.The MFMC in municipality of Kamenica has started the work in 1955, first as “Home of health”.	Član 2 Status GCPM 1.GCPM ima status javnog pravnog lica, u svojstvu autoriteta poslodavca, gde se organizuje, pruža i primenjuje Javna Primarna zdravstvena nega (u daljnjem tekstu: PZN). 2.Osnivač GCPM je Skupština opštine opštine Kamenica. 3.GCPM u opštine Kamenica je počeo sa radom 1955 godine, prvo kao “Dom zdravlja”.
II - Emërtimi dhe Selia Neni 3 Emërtimi 1.Emri i institucionit është: Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare “Dr. Shaban Geci” në Kamenicë. 2.Shenja njohëse e këtij institucioni është unike për të gjitha QKMF në Republikën e Kosovës dhe aprovet nga Kuvendi Komunal, në bazë të procedurave ligjore.	II - Designation and Headquarter Article 3 Designation 1. The name of the institution is: Main Family Medicine Center "Dr Shaban Geci" in Kamenica. 2.The recognition mark of this institution is unique for all MFMC in the Republic of Kosovo and is approved by the Municipal Assembly, on the basis of legal procedures.	II – Naziv i Sedište Član 3 Naziv 1.Naziv institucije je: Glavni Centar Porodične Medicine “Dr. Shaban Geci” u Kamenici 2.Identifikacioni znak ove ustanove je jedinstven za sve GCPM u Republici Kosovo i usvaja se od Skupštine opštine, na osnovu pravnih procedura.

3.Emërtimi i QKMF, QMF dhe AMF duhet të jetë i mbishkruar qartë në hyrje të institucionit shëndetësor përkatës të KPSH. 4.Për ndryshimin e selisë së QKMF vendos themeluesi, pas marrjes së pëlqimit nga Ministria e Shëndetësisë. Neni 4 Selia Selia e QKMF “Dr. Shaban Geci” gjendet në rrugën “Ismail Ismajli” Nr. 19 në Kamenicë Neni 5 Vula 1.QKMF posedon vulën e saj që në qarkullimin juridik paraqitet si Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare. 2.Vula është në formë të rrumbullakët dhe ka dimension 3.5 cm (35 mm). 2.1. Rrethi i parë: Republika e Kosovës; 2.2. Rrethi i dytë: Komuna e Kamenicës 2.3 Rrethi i tretë:QKMF “Dr. Shaban Geci” në Kamenicë 2.4. Në mes të vulës është logoja unike për të gjitha QKMF në Republikën e Kosovës.	3.The name of MFMC, FMC and FMA should be clearly indicated at the entrance of the respective health institution of PHC. 4.Changing of the MFMC headquarter shall be decided by the founder, upon obtaining the consent of the Ministry of Health. Article 4 Headquarter The MFMC“Dr. Shaban Geci”headquarters in Kamenica is located at str. “Ismail Ismajli” Nr.19 Article 5 Stamp 1.MFMC possesses its stamp, which in the legal circulation is presented as the Main Family Medicine Center. 2.The stamp is of round shape and has a dimension of 3.5 cm (35 mm). 2.1. First circle: Republic of Kosovo; 2.2.Secondcircle:Municipality of Kamenica. 2.3.Third circle: MFMC Dr. Shaban Geci”in Kamenica. 2.4. In the middle of the stamp stands the unique logo for all MFMCs in the Republic of Kosovo.	3.Naziv GCPM-a, CPM-a i APM-a mora biti jasno nadpisan na ulazu dotične zdravstvene ustanove PZN-a. 4.Za promenu sedišta GCPM-a odlučuje osnivač, nakon dobijanja pristanka od Ministarstva zdravstva. Član 4 Sedište Sedište GCPM-a “Dr. Shaban Geci” u Kamenici se nalazi u ul. “Ismail Ismajli”Nr.19. Član 5 Pečat 1.GCPM ima svoj pečat koji se u pravnom protoku predstavlja kao Glavni centar porodične medicine. 2.Pečat je okruglog oblika i dimenzija 3.5 cm (35 mm). 2.1. Prvi krug: Republika Kosovo; 2.2. Drugi krug: Opština Kamenica. 2.3. Treći krug: GCPM “Dr. Shaban Geci”Kamenica 2.4. Na sredini pečata je jedinstveni logo za sve GCPM-ove u Republici Kosovo.
---	--	---

3.QKMF posedon vulën katrore, me dimensione 5.5 cm x 3 cm. që përmban emërtimin, selinë dhe hapësirën për evidentimin e numrit dhe të datës së pranimit të dokumentit. 4.Vula duhet të përmbajë emërtimin e institucionit, sipas këtij Statuti dhe të jetë në gjuhët të cilat janë në përdorim zyrtar në Kosovë. 5.Për numrin e vulave, mënyrën e përdorimit dhe autorizimin e personit për përdorim dhe ruajtje vendos drejtori. 6. Çdo vulë ka numër identifikues. III-Veprimtaria, Shërbimet dhe Përfaqësimi i QKMF Neni 6 Veprimtaria 1.Veprimtaria e QKMF përfshinë ofrimin e shërbimeve shëndetësore në KPSH për popullatën e komunës, si një veprimtari me interes të veçantë, përmes zbatimit të konceptit të mjekësisë familjare, në kuadër të sistemit unik shëndetësor të Kosovës.	3.MFMC possesses the square stamp, of dimensions 5.5 cm x 3 cm. which contains the name, headquarter and space for recording the number and date of the receipt of document. 4.The stamp must contain the designation of the institution and according to this Statute must be in the languages, which are in official use in Kosovo. 5.The number of stamps, the manner of using the stamp and authorizing of persons for using and preserving the stamp shall be decided by the director. 6. Each stamp has an identification number. III-Activity, Services and Representation of MFMC Article 6 Activity 1.The activity of MFMC includes the provision of health services in PHC for the population of the municipality, as an activity of special interest, through the implementation of the concept of family medicine, within the unique health system of Kosovo.	3.GCPM ima četvrtasti pečat, sa dimenzijama 5.5 cm x 3 cm. koji sadrži naziv, sedište i površinu za evidentiranje broja i datuma prijema dokumenta. 4.Pečat treba da sadrži naziv institucije, prema ovom Statutu, i da bude na jezicima koji su u službenoj upotrebi na Kosovu. 5.O broju pečata, načinu korišćenja i o ovlašćenom licu za korišćenje i čuvanje odlučuje direktor. 6. Svaki pečat ima identifikacioni broj. III-Delatnost, usluge i zastupanje GCPM Član 6 Delatnost 1.Delatnost GCPM-a obuhvata pružanje primarnih zdravstvenih usluga u PZN-u za stanovništvo opštine, kao delatnost od posebnog interesa, kroz primenu koncepta porodične medicine, u okviru jedinstvenog zdravstvenog sistema Kosova.
---	---	--

2.Koncepti i mjekësisë familjare konsiston që të gjithë banorëve të Komunës së Kamenicës t'u ofrojë shërbime shëndetësore gjithëpërfshirëse, efikase dhe në vazhdimësi individit dhe familjes në të gjitha fazat e jetës, bazuar në të dhëna shkencore, përmes mjekut familjar si mjek i përzgjedhur i cili do të jetë portë hyrëse për të gjithë kërkuesit e shërbimeve në sistemin shëndetësor dhe njëherit pikë referuese për specialistët konsulantët në KPSH dhe në nivelet tjera të kujdesit shëndetësor. 3.Sipas SSSH 2017-2021 dhe standardeve të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë, ekipi i mjekësisë familjare i përbërë nga një mjekë familjar dhe dy infermiere familjare ofron shërbime shëndetësore për 2000 banorë sipas shtrirjes territoriale, gjeografike dhe organizimit të QKMF. 4.Standardet në mjekësinë familjare sipas këtij statuti, do t'i nënshtrohen revidimit periodik nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë. 5.Shërbimet shëndetësore në QKMF (emri i komunës përkatëse) sigurohen dhe zbatohen nga profesionistët shëndetësor të cilët i plotësojnë kriteret e parapara në Ligjin për shëndetësi:	2.The concept of family medicine consists in provision of comprehensive, efficient health services to all residents of the Municipality of Kamenica and in continuation to individuals and families at all stages of life, on the basis of scientific data, through the family doctor as appointed doctor who will be the gateway for all service seekers in the health system and, at the same time, a reference point for specialist consultants in the PHC and other levels of health care. 3.According to HSS 2017-2021 and standards set by the Ministry of Health, the family medicine team consisting of a family doctor and two family medicine nurses provides health services for 2000 inhabitants according to the territorial, geographical area extent and organization of MFMC. 4.According to this statute the standards in family medicine will be subject to periodic review by the Ministry of Health 5.Health services in the MFMC in (the name of the respective municipality) are provided and implemented by health professionals who meet the criteria set out in the Law on Health:	2.Koncept porodične medicine se sastoji u tome da se svim stanovnicima opštine Kamenica pružaju sveobuhvatne i efikasne zdravstvene usluge, u kontinuitetu, pojedincu i porodici u svim životnim etapama, na osnovu naučnih podataka, kroz određivanje porodičnog lekara, koji će biti ulazna kapija za sve one koji zahtevaju usluge u zdravstvenom sistemu, i istovremeno referentna tačka za savetnike specijaliste u PZN-u i na ostalim nivoima zdravstvene nege. 3.Prema SZS-u 2017-2021, i standarda određenih od Ministarstva zdravstva, ekipa porodične medicine koja se sastoji od jednog porodičnog lekara i dve porodične medicinske sestre pruža zdravstvene usluge za 2000 stanovnika u zavisnosti od teritorijalnog i geografskog prostiranja kao i organizovanja GCPM-a. 4.Standardi porodične medicine prema ovom statutu će se podvrgavati periodičnom revidiranju od strane Ministarstva zdravstva. 5.Zdravstvene usluge u GCPM- (ime dotične opštine) se obezbeđuju i primenjuju od zdravstvenih profesionalaca koji ispunjavaju kriterijume predviđene Zakonom o zdravstvu:
--	---	---

